



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 194, Datë, 26.11.2020**

**“MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ENERGY SUPPLY - AL” SH.P.K., NR 310, SERIA F11/FK15, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT NR. 5, DATË 02.02.2011 DHE RINOVUAR ME VENDIMIN NR. 123, DATË 14.10.2015”.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç” të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”; 5 pika 1, gërma “d”, nenit 8, 9, 10 pika 1 dhe 3, si dhe nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, i ndryshuar, nenit 19, pika 1, gërma “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Mbikqyrjes dhe Autorizimeve, me nr. 122/6 prot, datë 18.11.2020, lidhur me rinovimin e licencës të shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit me energji elektrike,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “Energy Supply - AL” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1185 prot, datë 10.11.2020, ka aplikuar për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, nr. 310, Seria F11/FK15, miratuar me vendimin e Bordit nr. 5, datë 02.02.2011 dhe rinovuar me vendimin nr. 123, datë 14.10.2015.
- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Në datën 20.01.2010, është e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k), konform ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.
- Shoqëria “Energy Supply - AL” sh.p.k., është mbajtëse e licencës me nr.310, Seria F11/FK15, të furnizimit të energjisë elektrike që prej datës 02.02.2011, dhënë me vendimin e Bordit të

Komisionerëve të ERE-s nr.5, me afat vlefshmërie deri në datën 02.02.2016, e cila më tej është rinovuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 123, datë 14.10.2015, për pesë vjet të tjera, deri në datën 03.02.2021.

- Në nenin 16, pika 1, të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, e ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo me vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.
- Shoqëria e ka depozituar aplikimin e saj në ERE, brënda afatit që përcakton neni 16, pika 1, sipërcituar, (datë 10.11.2020).
- Shoqëria “Energy Supply - AL” sh.p.k., ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndër vite dhe për vitin 2019, ndaj ERE-s.
- Dokumentacioni i aplikimit është kryesisht i plotësuar dhe më poshtë rendisim atë që mbetet ende i paplotësuar:

#### **Formati i aplikimit sipas nenit 9, pika 1**

- **gërma “c”** (të dhëna për aplikuesin). **Plotësuar.**

#### **Dokumentat juridike, administrative dhe pronësore**

##### **Neni 9, pika 2:**

- **gërma “d”** (Vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata). **Plotësuar pjesërisht.** Mungojnë vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë për përfaqësuesin me prokurë të shoqërisë. Po ashtu vihet re edhe mungesa e organeve të drejtësisë për administratoren (nga vendi i saj i origjinës, Bullgaria), për të cilat do t’i kërkohej shoqërisë depozitimi në ERE.

#### **Dokumentat financiare dhe fiskale, sipas nenit 9, pika 3**

- **gërma “c”** (Dokumenta që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.) **Plotësuar pjesërisht.** Duhet të depozitohet në ERE dokumentacionin mbështetës.

#### **Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike**

##### **Neni 9, pika 4.7:**

- **gërma “a”** (Të dhëna për sigurimin e energjisë elektrike për furnizimin e klientëve). **Pa plotësuar.**
- **gërma “b”** [Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj]. **Plotësuar pjesërisht. Shoqëria ka depozituar në ERE deklaratën për disponimin e të ardhurave, por duhet të dokumentojë disponimin e të ardhurave për garantimin e aktivitetit.**

- **gërma “c”** (Lista e kontratave aktuale dhe të mëparshme /nëse ka, për blerjen dhe sigurimin e energjisë elektrike). **Pa plotësuar.** Shoqëria duhet të dorëzojë listën e kontratave që ka pasur apo të bëjë me dije nëse nuk ka pasur.
- **gërma “d”** (Informacioni i detajuar tekniko-financiar lidhur me përmbushjen e këtyre kontratave). **Pa plotësuar.** Shoqëria nuk ka përcjellë informacionin e kërkuar nga kjo pikë e Rregullores, por duhet ta depozitojë në ERE.
- **gërma “e”** (Sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi). **Pa plotësuar.** Shoqëria “Energy Supply - AL” sh.p.k., nuk ka përcjellë sistemin IT me të cilin operon, por duhet ta paraqesë atë.
- **gërma “f”** (Dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do ti ofrohen klientëve). **Pa plotësuar.** Shoqëria nuk ka bërë me dije në lidhje me disponimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit. Duhet të depozitojë dokumentacionin përkatës.
- **gërma “h”** (Të dhëna për klientët dhe energjinë e furnizuar (kategoritë, nënkategoritë, numri i konsumatorëve, sasia e energjisë në GWh në vitin e ( I, II, III, IV dhe V), lidhja në Un, Fuqia e instaluar e konsumatorëve, aktiviteti (familjarë, buxhetorë, privatë)). **Pa plotësuar.** Shoqëria nuk ka përcjellë në ERE të dhëna për këtë kërkesë të Rregullores.
- **gërma “i”** (Niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët). **Plotësuar.**

Për dokumentacionin e munguar, do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nenit 10 dhe 11, ti paraqesë këto në ERE, brënda afateve

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

#### Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k., me nr. 310, Seria F11/FK15, miratuar me vendimin e Bordit nr. 5, datë 02.02.2011 dhe rinovuar me vendimin e Bordit nr. 123, datë 14.10.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 04.02.2021.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**